

**STATUTI I SHOQERISE  
“EUROBUSHI AH SHPK”**

Ne respektim te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “,ndryshuar me ligjin 129/2014 ligjt 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me cilesine e ortakut themelues te shoqerise :

1. I mbajtur sot, me date 20.11.2019 , Z. **BEKIM HAJDARMATAJ** i biri I AVNIUT dhe BEDRIES i datelindjes 26.05.1989 lindur e banues ne BAJRAM CURRI , LAGJIA PARTIZANI , RRUGA BYLBYL BRECANI SHTEPI PRIVATE ,ZONA KADESTRALE 1347 ME NR PASURIE 4/127 I paisur me karte elektronike me nr personal I90526030W leshuar me date 21.02.2019 harton kete Statut te shoqerise EUROBUSHI A-H SHPK

*Hartojme kete statut te shoqerise me perjegjesi te kufizuar, me emertimin “EUROBUSHI AH SHPK”*

**KREU I**

**Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja,Objekti**

**NENI 1 EMERTIMI**

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“EUROBUSHI AH SHPK”**.



## NENI 2 FORMA JURIDIKE

Shoqeria "**EUROBUSHI AH SHPK**", eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "**EUROBUSHI AH SHPK**", është një e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

## NENI 3 SELIA

Selia e shoqërisë "**EUROBUSHI AH SHPK**", ndodhet me adresë : **LAGJIA PARTIZANI , RRUGA BYLBYL BRECANI SHTEPI PRIVATE ZONA KADESTRALE 1347 ME NR PASURIE 4/172.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, të krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.

## NENI 4 OBJEKTI I AKTIVITETIT

Shoqëria "**EUROBUSHI AH SHPK**", ka si objekt të veprimtarisë tregtare të saj, por pa u kufizuar.



Hoteleri Turizem , restorant Hapje e Bar- bufeve, , bilardo, pika te servisit, lavazh, parkimit, te mjeteve , kend lojerash etj

Tregtimit me shumice dhe pakice dhe import eksport te :

Te mallrave te ndryshme ushqimor, industrial, pije konfeksione, fruta-perime, materile ndertimi e nenprodukteve te tyre, elektro –shtepiake, prodhime buqesore e blektorale, orendi shtepiake, mobilje ,paisje elektrike dhe elektronike, hidro saniatre, hidraulike,kinkaleri,kancelari zyre e shkolle,, makina te ndryshme te reja e ne perdonim pjese kembimi per auto,baderi,goma, etj tregtim bimesh medicinal , eterovajore, plerash e prodhime kimike , prodhime kozmetike dhe stetike. Import eksport dhe tregti me shumice e pakice I materilaeve te ndertimit, Brenda dhe jashte vendit, per llogari te vete shoqerise apo te treteve ku pershihen pllaka apo blloqe, mermeri, granit, traventine, laminat, parket, hidrosanitare, inerte, rere blloqe, material adezive, hekur tulla , vegla pune, gure, gure decorative, gelqere, parafabrikate, tulla, llac, cimento, granile te fraksioneve te ndryshme si dhe cdo lloj materiali tjeter qe nuk eshte permendur ketu por qe perodret per qellime ndertimi


Import, eksport blerje , makina te ndryshme, pjese kembimi , shitje me shumice e pakice te te gjithe llojeve te automjeteve .brenda dhe jashte vendit .

Agjensi blerje e shitje dhenie e qira e pasurive te luajteshme e te paluajteshme, agjensive komisionere..

Import eksport, tregtim me shumic e pakice I paisjeve industrial, I mjeteve motorrike, autovetura, kamione, mjete buqesore e pjese kembimit te tyre. Transport udhetaresi si Brenda dhe jashte vendit.

Studime, projekte,peprunim e prodhime material ndertimi e prodhim betoni, parafabrikate e konstruksion per ndertim pallatesh , objekte industriale, ujesjellesa e kanale dhe ndertim rrugesh , ndertim , zbatim,punime dheu, sistemime,taracime terenash. Ndertime civile , dhe ekonomike, ndertime veprash arti, punime mbrojtje dhe sistemime hidraulike . Rikostruksione godinash civile , ekonomike, kryerja e situacioneve , preventivave dhe zbatim objektesh te ndryshme ndertimi .

Gjithashtu per te realizuar objektin dhe qellimet e saj. Shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti, tregtar financiar, qiradhenes apo dorezanes qe I vlereson te dobishme apo te nevojshme per arrijen e qellimeve te saj



## NENI 5 KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e aktivitetit veprimtarisë të shoqërisë “EUROBUSHI AH SHPK” SH.P.K, është e pakufizuar.

Kohëzgjatja e aktivitetit veprimtarisë të shoqërisë “EUROBUSHI AH SHPK” SH.P.K, fillon nga data e regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

## KREU II

### KAPITALI

#### NENI 6 KAPITALI THEMELTARE

Kapitali bazë i shoqërisë “EUROBUSHI AH SHPK” SH.P.K, është 100,000 lekë dhe eshte ne natyre nga ortaku i shoqërisë.

Kontributi i ortakut /ëve përbëjnë kapitalin themeltarë dhe të regjistruar të shoqërisë “EUROBUSHI AH SHPK” SH.P.K.

Kapitali bazë përbëhet nga kontributi i ortakut të vetëm: Z.Bekim Hajdarmataj zotëron 100 % kapitalin e shoqërisë me vlerë 100,000 leke.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.



## NENI 7 ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenhkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnjeh rast shumica nuk mund te detyrojte njeh ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqeris.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkoen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten masi ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojn.

Projekti i zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontabiel te autorizuar, ne rast se ka te tilli, te paktien 45 ditie perrrpara daties se mbledhjes se asambles te thirrur per te marr vendim rreth ketij projekti.

## NENI 8 TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te njeh shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqeris;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjetter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.



Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombëtare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

##### **NENI 9 ORGANI VENDIMARRES**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise që miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm pér një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

#### NENI 10 MENYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar pér mbledhjen e asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, pér të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.



## NENI 11 KOURUMI

- a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- b) Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumin të përmendur me lart, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## NENI 12 MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e Përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, miratimin e bilancit, kontrollin e llogarive, miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë, riorganizimin, bashkimin ose ndarjen e shoqerise, shnderimin në një forme tjeter, transferimin e kuotave, emerimin e eksperteve dhe likuidatoreve dhe prishjen e shoqërisë, zhvillon mbledhje, të cilat janë te vlefshme, kur ne te janë te pranishem ortaket me te drejte vote që zoterojne me shume se gjysmen e numrit total të kuotave të kapitalit të shoqerise të cilet votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligjit 9901 date 14.04.2008 dhe merren vendime të vlefshme me votimin pro te  $\frac{3}{4}$  te ortakeve pjesemarres.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesemarrës, kur ne te marrin pjesë ortakët me të drejtë vote te cilet zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) përcaktimin e shpërblimeve,



- ç) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- d) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### NENI 13 ADMINISTRIMI

Shoqeria do te administrohet nga një administrator .

*Administrator i shoqerise eshte Z. BEKIM HAJDARMATAJ i biri I AVNIUT dhe BEDRIES i datelindjes 26.05.1989 lindur e banues ne BAJRAM CURRI , LAGJIA PARTIZANI , RRUGA BYLBYL BRECANI SHTEPI PRIVATE ,ZONA KADESTRALE 1347 ME NR PASURIE 4/127 I paisur me karte elektronike me nr personal I90526030W I cili do te ushtrojne detyrat e administrimit te shoqerise per një periudhe 5 vjeçare me te drejte riperteritje.*

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrëthanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpëra datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjiston



largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji”.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe një person jashtë ortakerise.

#### NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

*Administratori ka të drejtë e detyrohet të:*

- a)të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem të veprimtarisë tregtare së shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetem,
- b)përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c)kujdeset përmbytjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç)përgatisi dhe nënshkruejë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d)krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përmes rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e)kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmes Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- ë)raportojë përparrë ortakut në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmes veprimtarinë e shoqërisë tregtare.



Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshи këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve, bankat e te gjitha niveleve, zyrat e tatimit taksave, doganave, zyrave te qeverisjes vendore etj.

Administratori nuk ka te drejte te nenshkruese kontrata huaje, hipoteke, pa marre me pare miratimin me shkrim te Asamblese se Ortakeve.

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asamblese se Ortakeve edhe ne rastet kur;

- a)sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- b)kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

#### NENI 15 PERGJEJGESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a)të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdus;
- b)të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c)të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.


2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin finanziar, nëse është e nevojshme.



Asnjë vendim i Asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kunder administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### NENI 16 VITI FINANCIAR

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

#### NENI 17 BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori/et.


Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi të jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### NENI 18 EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithe vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

#### NENI 19



Të ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi te ortakeve.

NENI 20

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i pa realizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligj;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, të ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

3. Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", dhe "dh", të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistanca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit



gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij nenit, shkaku i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij nenit, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

6. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij nenit, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

#### NENI 21

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvçese kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit/eve.

#### NENI 22 TE DREJTAT DHE DETYRIMET E LIKUJDUESIT

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave.

Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

#### NENI 23 PERFUNDIMI I LIKUJDIMIT

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

#### NENI 24 BASHKIMI

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthitura, të një shoqëri tjeter ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized 'J' or 'L' shape with a diagonal line extending from its top right, followed by a curved flourish.

## NENI 25 NDARJA

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblese se Ortakeve, duke transferuar të gjitha aktivitet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërise ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve të ligjit 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" ndryshuar me ligjin 129/2104.

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë: kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja përmarrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;  
a) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërise pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;  
b) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

## NENI 26 SHNDERRIMI

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.



## NENI 27 BAZA LIGJORE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoquerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

## NENI 28 MOSMARREVESHJET

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

## NENI 29 DISPOZITAT PERFUNDIMTARE

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njeja juridike, ne gjuhen shqipe, dhe miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare "**EUROBUSHI AH SHPK**", dhe nenshkruehet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

*ORTAKU I VETEM I SHOQERISE*

**"EUROBUSHI AH SHPK"**

**Bekim Hajdarmataj**

